




ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE



2014

Bankat për Shoqërinë
Raport CSR



Së bashku
për
njerëzit
shoqërinë
mjedisin
jetën

BANKAT PËR SHOQËRINË

ALPHA BANK

CRÉDIT AGRICOLE

SKT
SISTEMI KOMBËTAR
TE TRAZIMIT

Fibank
First Investment Bank

CREDINS bank

INTERNATIONAL COMMERCIAL BANK

CBA

CREDIT BANK OF ALBANIA
BANKA E KREDITËVE TË SHQIPËRIE

INTESA SANPIOLO BANK
Albania

NBG Bank

TIRANA
BANK

ProCredit Bank

UNIONBANK

Raiffeisen
BANK

UBA
United Bank
Albania
Banka e Bashkuar
e Prishtinës

SOCIETE GENERALE
ALBANIA

VENETO BANKA
GRUPPO VENETO BANCA

PARATHËNIE

Kompanitë dhe institucionet, gjatë viteve të fundit, i kanë kushtuar një rëndësi në rritje Përgjegjësisë Sociale të Korporatës (CSR) dhe impaktit në shoqëri të aktiviteteve të tyre operacionale, duke kontribuar vullnetarisht për një shoqëri më të mirë dhe një mjedis më të pastër.

Industria bankare, në mënyrë të natyrshme udhëheq përparimin dhe zhvillimin shoqëror dhe ekonomik, përmes financimit që mbështet rritjen e bizneseve dhe ekonomive. Po kështu, bankat kanë qenë ndër të parat që kuptuan rëndësinë e integritit të çështjeve sociale dhe mjedisore në biznesin e tyre, me politika të mirëfillta CSR. Nëpërmjet strategjive të mirë-konceptuara dhe të suksesshme CSR, bankat mund të ngrënë profilin e tyre dhe të kontribuojnë në zhvillimin e komunitetit të cilit i shërbejnë, ndërkohë që rrisin fitimet.

Edhe industria bankare në Shqipëri ka vite që ndjek këtë rrugë. Bankat në Shqipëri përfaqësojnë një total aktivesh që zë rreth 92 për qind të PBB-së kombëtare, dhe kanë kredituar ekonominë shqiptare për një total rreth 42 për qind të PBB-së. Deri në fund të vitit 2014, ato kishin rreth 6,800 të punësuar, të cilët trajnohen në mënyrë të vazhdueshme. Por, përtej kreditimit dhe zhvillimit të fuqisë punëtore, bankat shqiptare kanë treguar përkushtimin e tyre për të qenë qytetarë-korporativë të mirë në bashkësitë ku veprojnë, duke mbështetur organizatat jofitimprurëse, përmes aksioneve vullnetare, donacioneve dhe ekspertizës, për të sjellë një impakt pozitiv.

AAB e konsideron të rëndësishëm evidentimin e mënyrës sesi bankat shqiptare e kanë bërë CSR pjesë integrale të strategjisë së tyre të biznesit, dhe përcjelljen e informacionit mbi arritjet dhe kontributin e tyre në shoqëri.

Qëllimi i këtij raporti të parë është të paraqesë një listë, jo shteruese, të iniciativave CSR të ndërmarra nga bankat shqiptare gjatë 2014 dhe praktikave më të mira të kontributit të tyre ndaj komunitetit, duke shprehur të frymëzime të ardhshme CSR.

Endrita Xhaferaj

Sekretare e Përgjithshme e AAB

PËRMBAJTJA

 Parathënie.....	3
 Hyrje.....	5
 Aktivitetet sipas Sektorëve.....	7
 Shëndeti.....	7
 Mbështetje sociale	11
 Edukimi	20
 Mjedisi.....	24
 Art, Kulturë dhe Sport.....	29
 Çmime Speciale.....	37

Bankat në Shqipëri mbeten të angazhuara ndaj parimeve dhe vlerave që i kanë udhëhequr që nga themelimi i tyre. Është objektiv kryesor për secilën bankë të sigurojë besueshmëri, kredibilitet dhe efikasitet në shërbimet bankare. Bankat janë të angazhuara gjithashtu në investimin për punonjësit e tyre nëpërmjet kompensimeve dhe përfitimeve, kushteve të punës dhe mundësive të barabarta për zhvillimin e karrierës, ndërsa mbështesin komunitetin me projekte për shëndetësinë, arsimin, çështje sociale, mjedisi, kulture e sporti, në Shqipëri.

Fokusi kryesor gjatë vitit 2014 ka qenë mbi sektorin e shëndetësisë, ku kontributi i bankave ka qenë shumë i rëndësishëm. Në këtë kuadër, katër banka kanë sponsorizuar rikonstruksione, dhe kanë financuar blerjen e pajisjeve mjekësore, në 7 spitale dhe në 8 qendra mjekësore rajonale në vend.

Punonjësit e bankave janë bërë donatorë të rregullt të gjakut dhe bashkëpunimi me Kryqin e Kuq Shqiptar ka qenë shumë produktiv. Prej shumë vitesh tashmë bankat organizojnë në ambientet e tyre seksione dhurimi të gjakut, që janë gjithmonë të mirëpritura nga punonjësit e tyre. Departamentet e Komunikimit të bankave i mbështesin këto iniciativa nëpërmjet fushatave në mediat sociale duke dhënë një mesazh të fortë për të gjithë klientët e tyre.

Gjatë vitit ka pasur fushata të ndryshme sensibilizuese lidhur me shëndetin, dhe bankat janë impenjuar seriozisht të rrisin edhe më tej ndërgjegjësimin. Dy banka kanë bashkëpunuar ngushtë dhe janë përfshirë në fushata televizive dhe sponsorizimin e projektit “Maratona e Jetës” për të ndërgjegjësuar komunitetin mbi kancerin e gjirit.

Raporti paraqet edhe kontributin e sektorit bankar në mbështetjen sociale, në drejtim të shumë fondacioneve në vend, duke filluar nga ato të luftojnë për kauza të rëndësishme të tilla si Sindroma Down, Autizmi, Talasemia, integrimi i Romëve dhe fëmijëve të pambrojtur në shoqëri, jetimët, etj., deri tek fondacione që mbështesin njerëzit me aftësi të kufizuara, të moshuar të vetmuar dhe pacientë terminal.

Fondacioni për Sindromën Down, i themeluar së fundmi në Shqipëri, është mbështetur menjëherë nga katër banka që kanë përkrahur të gjitha iniciativat e tij gjatë vitit 2014. Dëshmia nga Znj. Emanuela Zaimi, themeluese e fondacionit, është një shembull konkret i partneritetit dhe mbështetjes së vazhdueshme që bankat i japin këtij komuniteti.

Në këtë pjesë të raportit paraqitet edhe kontributi që bankat u kanë dhënë institucioneve shtetërore dhe Bashkive të ndryshme në të gjithë vendin.

Arsimi është një sektor tjetër që ka marrë vëmendje të konsiderueshme nga bankat. Pesë banka kanë sponsorizuar iniciativa interesante të nxënësve dhe organizimin e eventeve promovuese në bashkëpunim me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Junior Achievement, Kolegjin Turgut Ozal, dhe Institutin Kulinar, për ti inkurajuar ata që të përdorin njohuritë teorike në praktikë. Bankat synojnë të punësojnë studentët më të mirë prandaj i mbështesin ata vazhdimisht në udhëtimin akademik, në bashkëpunim edhe me Drejtoritë Rajonale të Arsimit.

Çështjet e mjedisit kanë qenë gjithashtu në fokus të përgjegjësisë sociale të bankave. Ato kanë hartuar politika ambientale, targete, dhe praktika që udhëheqin aktivitetet e tyre kudo. Të menduarit ekologjikisht është bërë pjesë e operacioneve dhe shërbimeve bankare, kreditimit, por edhe e aktiviteteve në komunitet.

Bankat në Shqipëri kanë mbështetur fortësisht nismën "Të pastrojmë Shqipërinë", pjesë e nismës globale "Let's Do it!". 6 banka dhe punonjësit e tyre, të ndjekur edhe nga klientët, morën pjesë aktivisht në pastrimin e zonave të bregdetit apo pjesët e ndotura të qyteteve. Ndërkohë, bankat kanë qenë të përfshira edhe në riciklim apo iniciativa të gjelbra dhe ekologjike.

Bankat kanë kontribuar ndjeshëm gjatë vitit edhe për kulturën dhe artin, në qytete të ndryshme të vendit, si me organizimin e eventeve apo mbështetjen e atyre të organizuara nga institucione të tjera shtetërore ose private, ashtu edhe duke sponsorizuar aktivitete artistike dhe kulturore, kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjithashtu, bankat me kapital të huaj vazhdimisht mbështesin shkëmbimin e kulturës dhe traditës shqiptare me ato të vendeve të origjinës.

Bankat i kanë qëndruar pranë edhe botës së sportit: ato mundësuan gjatë vitit arritjen e sfidave si ngjitja e malit Everest nga alpinistët shqiptarë apo marrjen pjesë të ekipeve kombëtare në Kampionate Ndërkombëtare, ndërkohë që sponsorizojnë vazhdimisht ekipet dhe kampionatet vendase.

Duhet theksuar që edhe komuniteti e ka vlerësuar angazhimin e bankave: vetëm në vitin 2014, 3 banka u vlerësuan me çmime speciale për përfshirjen e tyre në CSR dhe kontributin e tyre për shoqërinë.

Dhurim Vullnetar i Gjakut



Grupi i Dhuruesve Vullnetarë të Gjakut **Intesa Sanpaolo Bank Albania** dhuron gjak rregullisht dy herë në vit për të ndihmuar fëmijët me talasemi, nën moton: "Dhuro gjak të shpëtosh një jetë!", në bashkëpunim të ngushtë me Shoqatën Shqiptare të Dhuruesve Vullnetarë të Gjakut. Këto iniciative organizohen në degët më të mëdha të bankës: Zyrat Qendrore në Tiranë dhe Dega e Rr. Barrikadave, ku numri i dhuruesve është rritur ndjeshëm. Përgjatë vitit, kontributi i bankës si institucion ndaj kësaj nisme humanitare ishte në total 166 orë pune.



Alpha Bank Albania, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar, organizuan për të katërtin vit radhazi Ditën e Dhurimit të Gjakut. Rreth 300 persona që vuajnë nga talasemia kanë nevojë për gjak çdo muaj. Shumë të tjerë kanë nevojë për gjak për shkak të aksidenteve, operacioneve, etj.. Për të sensibilizuar komunitetin për rëndësinë e dhurimit të gjakut, Alpha Bank nisi një fushatë në Facebook të quajtur "Unë dhuroj 5 minuta nga koha ime! Po ti?".

Tirana Bank në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar, organizoi në shtator për të gjashtin vit radhazi, dhurimin vullnetar të gjakut nga gjithë punonjësit e saj në gjithë vendin.

Ky akt njerëzor vjen në ndihmë të njerëzve në nevojë, veçanërisht fëmijëve që vuajnë nga talasemia dhe leukemia. Kësaj nisme iu bashkuan edhe klientët e bankës, por edhe vullnetarë që iu përgjigjën thirrjes së saj në media.



Banka Ndërkombëtare Tregtare, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar, organizoi në ambientet e bankës dy herë gjatë vitit seanca të dhurimit të gjakut në ndihmë të fëmijëve talasemikë.

Rikonstruktiv spitalesh dhe furnizim me pajisje mjekësore

Alpha Bank Albania financoi disa projekte në disa qendra spitalore, si Qendra Spitalore në Kamëz, ku mbështeti plotësimin e nevojave të qendrës për: krevate metalike, batanije, çarçafë dhe pajisje të tjera të nevojshme për trajtimin e pacientëve në dhomat e urgjencës.

Alpha Bank Albania dhuroi gjithashtu një Coagulometer, pajisje për matjen e aftësisë së mpiksjes së gjakut, për Qendrën Spitalore Nr. 6 në Kombinat, Tiranë.

Një tjetër donacion banka e bëri për Spitalin Rajonal "Omer Nishani" të Gjirokastrës, mundësoi vendosjen e sinjaleve brenda dhe jashtë spitalit, për të lehtësuar orientimin e pacientëve.



BKT sponsorizoi blerjen e një pajisjeje me ultratinguj për të përmirësuar cilësinë e ekzaminimeve gjinekologjike në Spitalin Nënë Mbretëreshë.

BKT gjithmonë pranë jush edhe për shëndetin tuaj!



Credins Bank financoi ndërtimin e laboratorit klinik dhe biokimik të Poliklinikën dhe Spitalin Rajonal, Durrës. Gjatë gjithë 2014, ky laborator do të jetë në dispozicion të kryerjes së të gjitha analizave me pajisje moderne, duke kontribuar në rritjen e cilësisë së kujdesit spitalor për qytetarët.

Nën moton "Credins Bank mbështet shëndetin në Shqipëri", banka mbështeti shëndetësinë edhe në Spitalin Rajonal të Vlorës, duke siguruar pajisje moderne spitalore për laboratorin e analizave të gjakut.

Banka mbështeti gjithashtu edhe rikonstrukcionin e ndërtesës kryesore të Spitalit Rajonal të Shkodrës dhe Spitalin Universitar Shefqet Ndroqi (sanatoriumi) duke financuar realizimin e projektit për përmirësimin e standardeve për akreditimin e shërbimeve të spitalit.



8 spitale
&
8 qendra
mjekësore
rajonale



Raiffeisen Bank sponsorizoi blerjen e materialeve spitalore të tilla si paketa testesh e reagentësh të nevojshme për diagnostikimin e pacientëve të klinikës së onkologjisë të Spitalit Universitar të Tiranës, Nënë Tereza, sipas marrëveshjes me Ministrinë e Shëndetësisë, në vlerë prej 30.000 Euro.

Sponsorizimet dhe dhurimet e **BKT** për kujdesin shëndetësor gjatë vitit 2014 përmblihen shkurtimisht më poshtë:

Qendra e Kujdesit Shëndetësor Rrëshen: Dhurim pajisjesh zyre për përmirësimin e cilësisë së shërbimit në spitalin që i shërben më shumë se 16.000 njerëzve.

Qendra e Kujdesit Shëndetësor Delvinë: Dhurim pajisjesh zyre për përmirësimin e cilësisë së shërbimit në spitalin që i shërben më shumë 12.000 njerëzve.

Drejtoria e Shëndetit Publik Devoll: Dhurim pajisjesh zyre për përmirësimin e cilësisë së shërbimit në spitalin që i shërben më shumë 35.000 njerëzve.

Drejtoria e Shëndetit Publik Berat: Donacione për përmirësimin e cilësisë së shërbimit dhe forcimin e marrëdhënieve institucionale.

Qendra e Kujdesit Shëndetësor Elbasan: Përmirësimi i sistemit të brendshëm të nënshkrimit, për lehtësimin e procedurave dhe shërbimit për 300.000 banorët e rajonit të Elbasanit në këtë qendër të madhe të shërbimeve mjekësore. BKT sponsorizoi edhe përmirësimin e kopshteve të spitalit psikiatrik të Elbasanit, që përdoren nga pacientët për çlodhje.

Drejtoria e Shëndetit Publik Gjirokastrë: BKT sponsorizoi një konferencë për shqyrtimin e mënyrave për përmirësimin e shëndetit publik në rajonin e Gjirokastrës.

Qendra e Kujdesit Shëndetësor Thoma Rrudha Patos, Fier: BKT kontribuoi në një program për përmirësimin e shëndetit publik dhe dhuroi pajisje për analiza gjaku, që banorët të mos udhëtojnë në qendra të largëta për këto analiza.

Qendra e Kujdesit Shëndetësor Rogozhinë: Dhurim pajisjesh zyre për përmirësimin e cilësisë së shërbimit në spitalin që i shërben më shumë 15.000 njerëzve.

Qendra e Kujdesit Shëndetësor Orosh: Dhurim pajisjesh zyre për përmirësimin e cilësisë së shërbimit në qendrën mjekësore që i shërben një komuniteti të shtrirë mbi një zonë të madhe dhe të largët.


Raiffeisen Bank mbështeti iniciativën e Drejtorisë së Përgjithshme të Spitalit Universitar dhe financoi projektin për pajisjen me uniforma të reja të punonjësve të spitalit.



Raiffeisen Bank sponsorizoi rindërtimin e hyrjes kryesore të Spitalit Rajonal të Korçës. Në ceremoninë e inagurimit z. John McNaughton, anëtar i Bordit Drejtues të Bankës, premtoi mbështetjen e vazhdueshme për sektorin e shëndetësisë.

Ndërgjegjësimi mbi Kancerin e Gjirit

Tirana Bank nderoi të mbijetuarit nga kanceri i gjirit, për të rritur ndërgjegjësimin ndaj hapave që mund të merren për të reduktuar rastet e kësaj sëmundjeje. Banka iu bashkua kësaj iniciative duke mbështetur fushatat televizive, dhe duke printuar e shpërndarë postera për rritjen e ndërgjegjësimit dhe inkurajimin e ekzamineve, në zyrën qendrore dhe të gjitha degët, për ndërgjegjësimin e stafit, klientëve dhe komunitetit.



10

Credins Bank mbështeti iniciativat për rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit mbi rëndësinë e parandalimit të kancerit të gjirit. Në këtë kuadër, banka sponsorizoi projektin "Maratona e Jetës".



Crédit Agricole Albania bashkëpunoi për të dytin vit radhazi me Shoqatën Kristiane të Grave të Reja në Shqipëri (YWCA) dhe institucione të tjera, në mbështetje të kësaj çështje të rëndësishme. Këtë vit, marshimi tradicional kundër kancerit të gjirit, organizuar më 31 Tetor, nisi nga sheshi Nënë Tereza drejt bulevardit kryesor. Gjatë rrugës ishin vendosur mini furgona dhe specialist të shëndetit ofruan mamografi falas për gratë. Stafi i bankës iu bashkua këtij marshimi simbolik.



Sindroma Down



Alpha Bank Albania ishte një nga sponsorët kryesorë të Konferencës “Shëndeti dhe Mirëqenia – Mundësi dhe barazi për të gjithë”, që u organizua në ditën Botërore të Sindromës Down, në 21 mars nga Jonathan Center. Konferenca synoi rritjen e ndërgjegjësimit në komunitet mbi Sindromën Down dhe mbledhjen e fondeve për zhvillimin dhe mbështetjen e personave me këtë sindromë në Shqipëri.



Banka e Bashkuar e Shqipërisë (UBA) mbështeti DSA dhe Qendrën e Shërbimeve dhe kontribuon për terapi shtesë pa pagesë në dobi të fëmijëve të prekur nga sindroma Down. Gjithashtu, në 29 Dhjetor 2014, UBA sponsorizoi dhe organizoi festën e fund-vitit për fëmijët e Fondacionit DSA.

First Investment Bank mbështeti Fondacionin për Sindromën Down në Shqipëri (DSA), që ofron terapi për zhvillimin e hershëm për më shumë se 25 fëmijë të lindur me sindromën Down dhe ofron mbështetje të pashembullt për ta dhe familjet e tyre. Ndihma dhe mbështetja e Fibank për këtë fondacion ka qenë e përhershme dhe do të vijojë.



11



Raiffeisen Bank mundësoi rindërtimin e ambienteve të reja të DSA dhe Qendrës së Shërbimeve për fëmijë, individë me sindromën Down dhe familjet e tyre. Kjo është qendra e parë e këtij lloji në Shqipëri.



Dëshmi

Emanuela ZAIMI

Themeluese dhe Kryetare Bordi
Drejtuese e Grupit të Suportit Prindëror
Down Syndrome Albania Foundation &
Achievement and Support Center



Fillimi i mbështetjes nga bankat për Down Syndrome Albania Foundation (DSA) daton në Shtator 2013, kur DSA sapo ishte themeluar dhe organizoi një koncert bamirësie me tenorin shqiptar me famë botërore, Z. Saimir Pirgu, Ambasador i kauzës sonë, për të siguruar një fond të parë operacional.

Raiffeisen Bank përqafoi e para iniciativën dhe sot, më tepër se një sponsorizues i aktiviteteve tona, është një partner strategjik, me mbështetjen e të cilit ekziston Qendra e Arritjeve dhe e Zhvillimit të DSA, ku marrin shërbim terapeutik të specializuar falas 30 fëmijë me sindromën Down dhe mbështeten me informacion, suport psikologjik dhe trajnime prindërit e tyre.

First Investment Bank mbështeti gjithashtu koncertin e bamirësisë në kuadër të muajit Tetor - muaji i ndërgjegjësimit për sindromën Down, duke blerë një numër të konsiderueshëm biletash për stafin. Që prej dy vjetësh Fibank kontribuon me blerjen e kartolinave të fundvitit të DSA, duke sjellë të ardhura në dispozicion të DSA për vazhdimësinë e ofrimit të terapive falas.

Në Dhjetor 2013 u bashkua me mbështetjen e saj edhe **Tirana Bank**, që dhuroi fonde për DSA dhe lodrat e vitit të ri për fëmijët e qendrës.

Në Dhjetor 2014, **Banka e Bashkuar e Shqipërisë**, bleu kartolina dhe organizoi festën me dhurata për Vitin e Ri për fëmijët e qendrës.

Aktivitetet e 21 Marsit të këtij viti u sponsorizua sërish nga Raiffeisen Bank.

Kontributi i bankave për DSA, në mënyrë të veçantë i Raiffeisen Bank, ka ardhur në përmbushje të dy qëllimeve: rritja e ndërgjegjësimit, dhe ngritja e kapaciteteve. Vlera totale e kontributit monetar kundrejt DSA nga sektori bankar në vend është 33.250 Euro, dhe afro 1.000 Euro janë kontributet në natyrë me dhurata dhe festa për fëmijët e qendrës.

Mbështetja e këtyre bizneseve të mëdha, ka ndikuar edhe në imazhin e DSA kundrejt donatorëve të tjerë të sektorit të biznesit, pasi reflekton seriozitetin e punës tonë dhe rezultatet e matshme të saj.

Sfida e radhës e DSA, është ngritja e një biznesi social, që do të ndihmojë atë për një autonomi dhe stabilitet financiar. DSA, e ndihmuar falas nga Deloitte Albania, po planifikon biznesin social "DSA Flower and Gift Shop", të ardhurat e të cilit do mundësojnë vazhdimin e ofrimit të shërbimeve terapeutike pa pagesë për fëmijët me sindromën Down. Qëllimi i dytë i këtij biznesi do të jetë punësimi i të rinjve me sindromën Down, duke ndihmuar kështu në përfshirjen e tyre në shoqëri dhe mundësinë e pavarësisë së tyre ekonomike.

Gjejmë rastin për tu bërë thirrje lexuesve për të na mbështetur në këtë sfidë. DSA shpreson ta inaugurojë çeljen e këtij biznesi në Tetor 2015, në kuadër të muajit të ndërgjegjësimit për sindromën Down.

Fondacione për fëmijë

Alpha Bank Albania mirëpriti ftesën e Fondacionit të Fëmijëve Shqiptarë, i cili mbështet fëmijët me autizëm dhe familjet e tyre me analiza dhe diagnoza, për të qenë pjesë e kësaj nisme, duke financuar trajnimet dhe trajtimet e një fëmije për 1 vit.

Banka dhuroi gjithashtu para për "Fondacioni Nëna e Fëmija" me aktivitet në maternitetet në Shqipëri, për të ndihmuar nënat e reja në vështirësi financiare. Me fondet e dhuruara u ble një aparat me rrexe-x për foshnjat.



BKT dhuroi fonde për Fondacionin e fëmijëve "Domenick Scaglione" për të ndihmuar në përpjekjet e tij për përmirësimin e cilësisë së jetës të fëmijëve autikë. Banka ka financuar gjithashtu rindërtimin e Shtëpisë së Verës për jetimët në Velipojë. Përveç donacioneve të veta, BKT ka ndihmuar për mbledhjen e fondeve nëpërmjet rrjeteve sociale.

Credins Bank mbështeti financiarisht Fondacionin e Fëmijëve Shqiptarë, për përkujdesjen për fëmijët në kushte të vështira.



**SOS FSHATRA
E FËMIJËVE
SHQIPËRI**

Credins Bank dhe **Banka Ndërkombëtare Tregtare** mbështesin prej vitesh Fondacionin "Fshati SOS", duke mbuluar shpenzimet për katër fëmijë të cilëve u sigurojnë një shtëpi dhe një jetë të shëndetshme.

Banka Ndërkombëtare Tregtare sponsorizoi, për të tretin vit radhazi dhe në bashkëpunim me Qendrën për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve (CRCA), organizatën "Shtëpia për të Drejtat e Njeriut". Fondi i dhuruar u përdor për të blerë 100 kuti veshjesh për fëmijët Romë që strehohen çdo ditë në ambientet e qendrës.



Intesa Sanpaolo Bank Albania mbështeti me një donacion Koncertin për Mbledhje Fondesh për Bamirësi, organizuar nga Caritas Shqipëri për fëmijët dhe grupet në nevojë. Të ardhurat nga biletat e koncertit shkuan për mbështetjen e Qendrës së Kujdesit të Përditshëm të njerëzve me aftësi të kufizuara mendore në Fushë-Krujë.

Intesa Sanpaolo Bank Albania dhuroi furnizime mjekësore Organizatës për Përkujdesjen e Fëmijëve me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike, familjet e të cilëve jetojnë në gjendje të vështirë ekonomike, me mungesa bazike.



Me rastin e Ditës së Jetimëve punonjësit e **Intesa Sanpaolo Bank Albania** dhuruan para dhe ushqim për familjet me fëmijë jetimë në Gjirokastër.

MBËSHTETJE SOCIALE

Societe Generale Albania ndihmoi edhe jetimët në nevojë të "Shtëpia e Foshnjeve" dhe "Personat me Aftësi të Kufizuara" në Korçë. Në dhjetor 2014, përfaqësuesit e bankës organizuan në Korçë evente për shpërndarjen e dhuratave për të dy këto shtëpi.



Societe Generale Albania, në bashkëpunim me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë, kontriboi për "Fshatin SOS" duke organizuar një ekspozitë me pikturat e fëmijëve të këtij fshati në 26 dhjetor 2014. Banka mundësoi zhvillimin e këtij eventi si dhe blerjen e disa prej pikturave të ekspozuara.



Raiffeisen Bank ishte sponsor i përgjithshëm i veprimtarisë "Një ditë si gjithë fëmijët e tjerë", organizuar nga Shoqata e Gjimnastikës Artistike Aerobike. Ky aktivitet u organizua në 20 maj, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Jetimëve. Në të morën pjesë rreth 500 fëmijë të moshës 5-21 vjeç, nga shkollat 9-vjeçare dhe të mesme dhe jetimoret në Tiranë, Durrës, Shkodër, Vlorë, Lushnje, Kosovë, Maqedoni dhe Ulqin, etj..



Credit Agricole Albania mbështeti për një vit seancat terapeutike ditore të nevojshme për një fëmijë me autizëm, të ofruara nga profesionistët në Qendrën Rajonale të Autizmit në Tiranë. Qendra është krijuar nga fondacioni "Fëmijët shqiptarë", një organizatë jo-fitimprurëse e fokusuar në diagnostikimin dhe trajtimin bashkëkohor të fëmijëve autikë, e cila u jep mbështetje 80 fëmijëve që vijnë nga të gjitha rajonet e Shqipërisë.



FONDACIONI
FËMIJËT SHQIPTARË
DOMENICK SCAGLIONE

www.albanianchildren.org

Kryqi i Kuq Shqiptar

Banka Ndërkombëtare Tregtare mori pjesë në fushatën e ndërgjegjësimit organizuar nga Kryqi i Kuq Shqiptar në Ditën Ndërkombëtare për Zhdukjen e Varfërisë (17 tetor 2014), ku punonjësit e bankës kontribuan vullnetarisht me shuma monetare dhe ushqim ose veshje për të ndihmuar njerëz shumë të varfër.



Intesa Sanpaolo Bank Albania dha donacion për Kryqin e Kuq për përgatitjen e pakove ushqimore për njerëzit në nevojë, në të gjithë Shqipërinë, për kujtim të Ditës Botërore të Urisë, 2014.

Tirana Bank për të dytin vit radhazi ua dedikoi personave në nevojë fondet e buxhetuara për dhurata të fund-vitit. Këto fonde shkuan për fëmijët në nevojë, veçanërisht ata që vuajnë nga talasemia dhe jetimët e komunitetit, për të cilët banka organizoi festën e fund-vitit.



Tirana Bank mbështeti të moshuarit e vetmuar në "Ditën Ndërkombëtare për Zhdukjen e Varfërisë" duke iu bashkuar iniciativës së Kryqit të Kuq Shqiptar me moton: "Mendoni për ata që nuk janë si ju". Në këtë kontekst, në zyrat e Kryqit të Kuq në Tiranë, Tirana Bank, për të tretin vit, shpërndau 100 pako ushqimore për të moshuarit që jetojnë vetëm.



Stafi i **Credit Agricole Albania** bashkëpunoi me Kryqin e Kuq Shqiptar nën moton "Njëëzitet në ndihmë të Njerëzve" dhe kontriboi vullnetarisht duke dhuruar veshmbathje, ushqime dhe lodra për njëëzitet në nevojë. Në pak ditë, u mbledh një shumë e konsiderueshme donacionesh. Donacionet e stafit u dërguan në zyrat qendrore të Kryqit të Kuq Shqiptar, ku vullnetarët përgatitën kuti ushqimesh dhe u ndanë veshje sipas grup moshave.



Fondacione të tjera

BKT sponsorizoi festën Vitit të Ri “Silueta e një ëndrrë”, një event për mbledhje fondesh për fëmijët në nevojë.



Veneto Banka, në bashkëpunim me Lions Club Tiranë, mundësoi sponsorizimin e dy karrocave elektrike për dy fëmijët e paralizuar të familjes Rushani në Komunitetin e Novoselës në qytetin e Vlorës.



Tirana Bank mbështeti Projektin Social “Ndhimo fëmijët e lindur me HIV/SIDA”, nëpërmjet thirrjes për mbledhje fondesh nën moton CSR të bankës “Tirana Bank kujdeset” në gjithë rrjetin e degëve, për pesë ditë. Përveç donacioneve vullnetare të punonjësve, Tirana Bank dhuroi një shumë parash për këtë kauzë edhe si Institucion.



Intesa Sanpaolo Bank Albania i dhuroi OJQ-së “Dëshmorët e Policisë së Shtetit” një shumë simbolike për të mundësuar organizimin e një aktiviteti kulturor për festimet e Ditës së Verës me fëmijët jetimë të Dëshmorëve të Policisë, duke e konsideruar mbështetjen ndaj fëmijëve, dhe sidomos atyre me më pak mundësi, jo vetëm si kontribut social, por si detyrë.



35% e punonjësve të bankës bëjnë donacione mujore nga paga e tyre në llogaritë e dy OJQ-ve: “Ryder Albania” dhe Fondacionit të Fëmijëve Shqiptarë “Fluturo për Jetën”.

- **Ryder Albania:** Për përmirësimin e cilësisë së jetës për pacientë terminal kanceri, me mbështetje mjekësore, psikologjike, dhe socio-ekonomike; për mbështetje jo vetëm për pacientin, por edhe për familjen; për ofrimin e programit trajnues dhe edukues mbi Kujdesin Paliativ; për lobim e influencim mbi politikat për Kujdesin Paliativ.

- **Fluturo për Jetën:** Misioni i Fondacionit është të ndihmojë fëmijët në nevojë, pavarësisht përkatësisë fetare apo etnike, duke u dhënë prioritet të sapolindurve dhe foshnjave të braktisura, me aftësi të kufizuara, dhe institucioneve të cilat mbështesin dhe ofrojnë ushqim, strehim dhe edukim për ta. Kontributi i tyre shtrihet në gjithë Shqipërinë.



Alpha Bank Albania dhe **Credit Agricole Albania** mbështetën projektin “Të ndiejmë botën përmes zërit”, i cili ka për qëllim përdorimin e zgjidhjeve teknologjike “text-to-speech” në mënyrë që të përmirësojë kushtet e jetesës për rreth 20.000 persona me dëmtime të shikimit. Projekti ofron mundësinë për të lexuar literaturën e kompjuterit nëpërmjet audio-s në gjuhën shqipe dhe mundësi për të verbërit për të aksesuar në mënyrë të pavarur materialet audio dhe të shtypura, vetëm në pak sekonda. Në sajë të një aplikimi të tillë kompjuterik do të jetë e mundur për të përpunuar, skanuar dhe lexuar të gjithë “informacionin e marrë” nga një person i verbër. Përveç kësaj, programi i jep mundësinë personave të verbër të moshave të ndryshme që përdorin telefonat e tyre celular me ekran lexues të ngjashëm.

Mbështetje për institucionet publike

Tirana Bank mbështeti Drejtorinë e Policisë së Tiranës duke financuar aktivitetet operacionale me veshje fosforeshente, radio komunikimi, shenja trafiku, si dhe me lyerjen e makinave të policisë. Në këtë mënyrë Tirana Bank kontribuon në vendosjen e ligjit dhe rendit në Tiranë duke ndihmuar policinë e shtetit.



Veneto Banka mbështeti financiarisht fushatën promovuese informative të konceptuar dhe projektuar nga Agjencia Kombëtare e Turizmit.



Veneto Banka financoi ndërtimin e një shatërvani të ri modern në zonën e Kombinatit, në Tiranë, të nevojshëm për një infrastrukturë bashkëkohore në një zonë shumë të populluar.



Intesa Sanpaolo Bank Albania sponsorizoi rikonstrukcionin e "Sallës së Mbledhjeve të Agro Biznesit" në ambientet e Ministrisë së Bujqësisë. Kjo zonë u transformua në një hapësirë inovacioni dhe prodhueshmërie, ndërkohë që banka mbështet, me produkte dhe shërbimeve të përshtatura, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të këtij sektori.



Në vijim të ndihmës të saj për bizneset, banka mbështeti një institucion kyç si Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR) me rindertimin e Pikës për Shërbimin Digital & Sallës së pritjes, për përmirësimin e kushteve për individët dhe bizneset. Banka gjithashtu mundësoi "Touch Screen Kiosk", ku mund të shfrytëzohen shërbimet e digjitalizuara të ofruara me këtë pajisje elektronike.



MBËSHTETJE SOCIALE

Alpha Bank Albania mbështeti rindërtimin e një shatërvani në Berat, si një vepër e rëndësishme artistike e qytetit, e vendosur në sheshin qendror të tij.



BKT sponsorizoi krijimin e një qendre trajnimi të shëndetit publik në Komunën Kashar dhe dhuroi pajisje zyre për përmirësimin e cilësisë së shërbimit në qendrën e Mjekimit të Studentëve Tiranë.



First Investment Bank sponsorizoi projektin e zhvilluar nga Bashkia e Vlorës, "Kamp Veror 2014". Ky aktivitet u organizua për fëmijë të zgjedhur nga Bashkia dhe fëmijët e familjeve që përfitojnë nga skema e mirëqenies sociale. Kampi veror u zhvillua në afërsi të shkollës 9-vjeçare "Speciale P.L.M" dhe numri i fëmijeve pjesëmarrës ishte rreth 60.



Raiffeisen Bank financoi rikonstrukcionin total të "Zyrës së Punës" së parë moderne në Tiranë. Ky projekt synoi sigurimin e një shërbimi të standardizuar të ndërmjetësimit të punësimit për qytetarët lokalë, dhe në këtë mënyrë rritjen e punësimit.

Raiffeisen Bank në bashkëpunim me Ministrinë e Rinisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Shërbimin Kombëtar të Punësimit, financoi rikonstruktimin e Zyrës së Punës në Gjirokastrë.



First Investment Bank sponsorizoi për të tretin vit radhazi projektin mbi Punësimin Sezonal të Studentëve të organizuar nga Bashkia e Korçës. Rreth 60 studentë të përfshirë në projekt morën certifikata nga të dy institucionet.



Intesa Sanpaolo Bank Albania

mbështeti Qendrën Sociale të Bashkisë së Tiranës “Shtëpia jonë e përbashkët”, që mbështet rreth 100 njerëz të grupeve në vështirësi (persona me aftësi të kufizuar, fëmijë në situatë rruge, jetimë, gra të dhunuara dhe pleq të braktisur) me shërbime socio-psikologjike, fizioterapi dhe ushqim. Banka mundësoi për ta një udhëtim kulturor në Krujë dhe vizitë në muzeun e Skënderbeut (heroi kombëtar) me rastin e Ditës së Pavarësisë; mbështeti rindërtimin e bibliotekës së Qendrës; organizoi festën e Halloween për fëmijët; si dhe dhuroi pako ushqimore për familjet për festimet e fund-vitit.



Raiffeisen Bank ka mbështetur vazhdimisht Bashkinë e Kuçovës në shumë projekte që kjo Bashki ka zhvilluar, dhe do të vazhdojë ta mbështesë atë. Në mirënjohje, Bashkia i vuri rrugës kryesore të qytetit emrin “Raiffeisen Bank” me rasin e 10-vjetorit të krijimit të kësaj banke në Shqipëri. Në ceremoninë e rastit, banka i dhuroi Bashkisë një Çek me vlerën 500.000 lekë, për ta përdorur në shërbim të komunitetit të Kuçovës.

Raiffeisen Bank ka vijuar kontributin e saj edhe këtë vit për qytetin e Sarandës ku ka sponsorizuar projektin « Rikualifikimi i pishinës së hapur dhe ambienteve mbështetëse» në bashkëpunim me Bashkinë e qytetit.



Intesa Sanpaolo Bank Albania mbështeti edhe Bashkinë e Korçës në disa nisma gjatë vitit, për përmirësimin e qytetit për banorët dhe vizitorët e tij. Publikimi i hartave për shëtitje në qytet si dhe ri-dizejtimi i një faqeje interneti të mirë-strukturuar ishin projekte për përmirësimin e infrastrukturës së vendit, duke qenë pjesë e zhvillimit ekonomik të tij.



Projekte inovative

Alpha Bank Albania sponsorizoi një nismë inovative të organizuar nga Junior Achievement Albania, që synonte të frymëzonte studentët për krijimin e ideve të biznesit. Studentët, pjesë e rrjetit Junior Achievement, krijuan 22 biznese, si dhe i reklamuan ato e shitën prodhimet e tyre për vizitorët pranë një qendre tregtare. Fituesit ndër ta përfaqësuan Shqipërinë në Konkursin Evropian që u zhvillua në Estoni në korrik.



Tirana Bank mikëpriti një studente të vitit të fundit të shkollës së mesme të përzgjedhur nga organizata Junior Achievement për të kaluar një ditë të tërë në ambientet e zyrave qendrore të bankës. Gjatë qëndrimit të saj, ajo u informua me punët që kryejnë të gjitha departamentet në bankë.

Junior Achievement është organizata më e madhe në botë, e cila edukon dhe frymëzon të rinjtë për të vlerësuar lirinë e sipërmarrjes, biznesit dhe ekonomisë në dobi të përmirësimit të cilësisë së jetës së tyre.



Intesa Sanpaolo Bank Albania, në bashkëpunim me Intesa Sanpaolo Group, vijoi të përfshijë studentët e universiteteve në projekte konkurruese duke u dhënë atyre mundësinë për të fituar eksperiencë praktike në mjedisin e sotëm të biznesit. 12 studentë morën pjesë në konkursin 3-mujor, duke paraqitur projekte në fushën e shërbimit të klientit. Ky projekt ka për qëllim tu japë studentëve mundësinë të përdorin njohuritë teorike në zhvillimin e ideve të reja mbi tema të veçanta, por edhe për të provuar aftësitë e tyre në kushte reale të biznesit, ku ata do të punojnë së shpejti.



BKT sponsorizoi panairin e karrierës së studentëve të Kolegjit Turgut Ozal, ku studentët e Kolegjit mundën të njiheshin me përfaqësues nga bota e biznesit.



Veneto Banka mbështeti studentët e Institutit të Kulinarisë së Tiranës për të hapur bizneset e tyre të vogla.



Societe Generale Albania mbështeti "Tirana Startup Weekend". Konkursi u zhvillua në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Më shumë se 100 sipërmarrës të rinj - më së shumti studentë nga universitetet shqiptare - u mblodhën, kartësuan idetë e tyre dhe krijuan ekupe konkurrenente. Objektivi ishte krijimi i një biznesi të ri brenda afatit kohor të një fundjavë të vetme (54 orë), paraqitja e produkteve të biznesit para një paneli jurie, dhe fitorja e njërit prej tre vendeve të para që japin shpërblime monetare dhe mundësinë për të konkurruar në konkursin Global StartUp.

Studentët e shkëlqyer

BKT sponsorizoi pjesëmarrjen e tre studentëve në Olimpiadën Ndërkombëtare të Matematikës, organizuar nga Drejtoria Arsimore Rajonale e Durrësit.

Maths

Intesa Sanpaolo Bank Albania, sipas marrëveshjes me Zyrën e Punës në Drejtorinë Rajonale të Tiranës, për bashkëpunim në projektin e praktikës profesionale si pjesë e programit për nxitjen e punësimit, trajnoi 15 praktikantë të zgjedhur nga listat e Zyrës Punës dhe nga Panairi i punës. Të diplomuarit përfituan mbështetje financiare gjatë tre muajve të praktikës profesionale në bankë.



Credins Bank sponsorizoi eventin e organizuar me rastin e përfundimit të vitit akademik të shkollave të mesme në Tiranë. Ky aktivitet u organizua nga Drejtoria Arsimore Rajonale të Tiranës, nën drejtimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve. Përveç mbështetjes financiare për organizimin e eventit, Credins Bank u dhuroi 150 të diplomuarve të shkëlqyer karta Visa Prepaid, secila me vlerë prej 2.000 lekë.



7000
maturantë të
gjimnazeve të
Tiranës morën
pjesë në aktivitet

Donacione për shkollat dhe drejtoritë arsimore

BKT, në funksion të misionit për të mbështetur edukimin në vend, financoi rindërtimin e ambienteve të Zyrës së Arsimit Publik të Kamzës – një institucion i rëndësishëm për koordinimin e arsimit në Kamzë.

BKT në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore Rajonale Korçë ka mbuluar kostot e transportit për një nxënës që jeton në një distancë të largët nga shkolla më e afërt, duke bërë të mundur pjesëmarrjen e tij në mësim.



Tirana Bank ndihmoi Drejtorinë Arsimore në Pogradec, në projektin e ri të saj: “Dixhitalizimi i klasave të mësimt”. Në këtë kontekst, Tirana Bank sponsorizoi blerjen e një tablete interaktive dixhitale (Tabelë e zgjuar), e cila do të ndihmojë në përditësimin e metodave të mësimdhënies.



Credit Agricole Albania dhe Intesa Sanpaolo Bank Albania bënë një donacion për “Shkollën Franceze të Tiranës” për të ndihmuar në këto kohë të vështira për blerjen e pajisjeve për studentët e saj, për të lehtësuar procesin e të mësuarit dhe mundësuar shkëmbimin kulturor mes dy vendeve.

Intesa Sanpaolo Bank Albania mbështeti gjithashtu shkollën publike fillore “Jeronim De Rada” në Tiranë, për blerjen e karrigeve dhe pajisjeve shkollore si dhe për festimin e 100 vjetorit të figurës së rëndësishëm të letërsisë shqipe, Jeronim De Rada, emrin e të cilit mban shkolla.



Raiffeisen Bank dhuroi 20 kompjutera për shtëpinë e fëmijës “Zyber Hallulli” në Tiranë, në kuadër të Javës së Inovacionit e cila u organizua nga Ministria e Inovacionit dhe Administratës.

Raiffeisen Bank mundësoi me rastin e festave, një kënd lojrash për fëmijët e Shkollës Speciale “Luigj Gurakuqi” në Tiranë, i cili do të shërbejë për argëtimin dhe zbatimjen e nxënësve të këtij institucioni.



Projektet Speciale

Intesa Sanpaolo Bank Albania mbështeti konferencën e njohur ndërkombëtarisht të bisedave TED (Teknologji, Argëtim, Dizajn) me folës shqiptarë dhe të huaj – figura shumë të vlerësuar në fushat e tyre që janë impenjuar fortësisht për të marrë rezultate dhe për të sjellë kontribute inovative për shoqërinë në mënyra të ndryshme. Banka sponsorizoi këtë aktivitet që frymëzon gjeneratat e reja dhe profesionistët, të rrisin motivimin dhe ndjeshmërinë e tyre ndaj shoqërisë.



Tirana Bank mbështeti prodhimin e një dokumentari mbi zbulimin e naftës dhe zhvillimit në Shqipëri, titulluar "Nxjerrja dhe përpunimi i naftës në Shqipëri", i cili do të jetë një gur themeli për këtë kategori. Publiku shqiptar dhe ai i huaj do të ketë një historik të detajuar për zhvillimin e kësaj industrie të rëndësishme.



Intesa Sanpaolo Bank Albania mori pjesë në darkën e organizuar nga Fondacioni Vodafone Albania duke kontribuar në mbledhjen e fondeve për zhvillimin e një software të posaçëm që do të mundësojë leximin audio të materialeve të shkarkuar nga kompjuteri. Kjo do të ndihmojë të verbrit shqiptar për t'u integruar në sistemin e arsimit dhe ambientin e punës. Darka u organizua në Hotel Rogner në errësi të plotë dhe të ftuarit u shoqëruan në tavolinat e tyre nga persona të verbër.



Tirana Bank në bashkëpunim me Agjencinë Zviceriane për Zhvillim dhe Bashkëpunim në Shqipëri (SDC) bëri të mundur për punonjëset e tij, mamatë e fëmijëve nga 1-6 vjeç, trajnimin me temë "Prindër të mirë" të drejtuar nga profesor Gëzim Tushi. Ai diskutoi me nënat, mbi zbatimin e parimeve të mira dhe pozitive prindërore dhe praktikat të cilat i ndihmojnë ato të bëhen të ekuilibruara dhe nëna të forta që mund të rrisin fëmijë të lumtur për brezin e ardhshëm të shoqërisë sonë.



Tirana Bank mbështeti një projekt për mësimin e gjuhës angleze për fëmijët e fshatit SOS, i cili kishte për qëllim të mësuarit dhe në të njëjtën kohë argëtimin e dy grupe fëmijësh gjatë periudhës shtator-dhjetor 2014. Projekti do të vazhdojë edhe për vitin 2015.



Të pastrojmë Shqipërinë

Intesa Sanpaolo Bank Albania kontribuoi për këtë nismë me kontribut financiar; me vullnetarizimin e punonjësve gjatë orarit të punës (120 orë pune); dhe me donacione në natyrë (doreza plastike dhe qese plastike mbeturinash).



BKT sponsorizoi për të dytin vit radhazi këtë fushatë kombëtare, e cila ishte shumë efektive në pastrimin e disa prej zonave më të ndotura të bregdetit dhe qyteteve të Shqipërisë.



Societe Generale Albania sponsorizoi nismën e Komunës Hudenisht për të pastruar bregun e liqenit në Lin, me rastin e hapjes së sezonit turistik.



ProCredit Bank - më shumë se 170 punonjës ndërmorën me entuziazëm një aksion pastrimi pak para hapjes së sezonit turistik, në 5 zona turistike: Deti Adriatik (Velipojë, Durrës), Deti Jon (Vlorë), mali i Dajtit (Tiranë), Liqeni i Ohrit (Pogradec).

Raiffeisen Bank mbështeti Forumin Mendimi i Lirë në nismat për pastrimin e bregdetit shqiptar, të cilave iu bashkuan në pranverë edhe punonjës të bankës, për të pastruar plazhet në Spille, Kavajë, Gjiri i Lalzit, dhe Gjiri i Velipojës.



Riciklimi

Banka Ndërkombëtare Tregtare bashkëpunoi gjatë vitit me kompaninë e riciklimit “Riciklim i Gjelbër” për riciklimin dhe trajtimin e mbeturinave në degët dhe ambientet e saj, dhe deri në fund të vitit kishte kontribuar me riciklimin në total të 1026 kg letrave dhe 8 Tonerave printimi, me ndikim të rëndësishëm në mjedis.



Intesa Sanpaolo Bank Albania iu bashkua “Projektit Shqiptar për Mbledhjen e Kapakëve” që konsiston në mbledhjen e tapave plastike, paratë e fituara nga riciklimi i të cilave përdoren për blerjen e karrigeve me rrota për personat me aftësi të kufizuara që nuk mund të përballojnë blerjen e tyre, ku 250 kg tapa = 1 karrige. Gjatë vitit 2014 banka mbledhi rreth 1000 kg tapa të vlefshme për blerjen e 4 karrigeve me rrota.

MBLIDH KAPAKË, TAPA PLASTIKE DHE NDIHMO PERSONAT ME NEVOJA TË VEÇANTA!

INTESA SANPAOLO BANK, ALBANIA ju fton të bëhen pjesë e projektit humanitar “Mbledhja e Kapakëve”, që ka për qëllim mbledhjen e tapave plastike, të mbledhurat pastaj dhe karrigeve me rrota për personat të nevojshëm për të. Në mënyrë të tillë mund të kontribuoni në mënyrë efektive për të ndihmuar, si dhe siguruar me karrige me rrota personat të nevojshëm të karrigeve me rrota për 1 BANKA SH.P.

250 KG TAPA/KAPAKË = 1 KARRIÇE ME RROTA
MBLEDHIMAT PERSONALË NË NEVOJË, NDIHME GJATË VITIT PËR RICIKLIMIN


MBLIDH TAPA PLASTIKE DHE NDIH NI KËTË KUTI!
Fajë gjatë i zgjedh të një vitet të mëdha ekologjike për zotëtarët e tyre dhe gjithashtu në qendrën e tyre të punës dhe në shtëpitë e tyre personale me rregull të veçanta.

INTESA SANPAOLO BANK, ALBANIA dhe Organizata e Solidaritetit Rinor, ju falënderojmë për kontributin tuaj!

INTESA SANPAOLO BANK
Ekipi i aktivitetit tuaj



Në 2014 RICIKLIMI I GJELBËR ka mbledhur nga ICB mbeturina jo të rrezikshme siç tregohet në infografikun e mëposhtëm :



Të dhënat i referohen periudhës nga 14/11/2013 deri 31/12/2014

Raiffeisen Bank mbështeti nismën “Unë Ricikloj” e cila është një nismë mjedisore që synon të motivojë komunitetin për një mjedis sa më të pastër me më pak mbeturina. Ky projekt ofron një program të mirëfilltë riciklimi dhe shërbimi ekologjik për ndarjen dhe grumbullimin e mbeturinave në zyra, biznese, qendra tregtare dhe më gjerë. Nëpërmjet bashkëpunimit të suksesshëm me Raiffeisen Bank është mundësuar vendosja e koshave të riciklimit në 32 pika të Tiranës.



Mbjellja e Pemëve


Alpha Bank Albania - Punonjësit e bankës, për të shtuar më shumë oksigjen dhe ngjyra në Shqipëri, në Ditën e Vullnetarizmit rinovuan parkun “Selman Stërmasi” në Tiranë dhe një park në qytetin e Ballshit. Me ndihmën e Bashkive në të dy qytetet, ata mbollën pemë dhe lule, dhe vendosën stola dhe kosha plehrash.



BKT sponsorizoi një projekt të Bashkisë në Tiranë për mbjellje pemësh, në bashkëpunim me donatorë të tjerë, përfshirë pjesëtarë të komunitetit lokal të biznesit dhe organizata kombëtare e ndërkombëtare. Qëllimi i projektit ishte zgjerimi i zonave të gjelbra të qytetit si edhe përmirësimi i jetës së shëndetshme të komunitetit.



Raiffeisen Bank financoi mbjelljen e 390 pemëve, në zonën e liqenit artificial në Tiranë, në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës.



Eco Volis

ProCredit Bank mbështet iniciativën e quajtur Ecovolis, një program që promovon mjete alternative të transportit, ekologjikisht miqësore, të tilla si biçikletat.

Në qershor, stafi dhe drejtuesit e ProCredit Bank Shqipëri, në bashkëpunim me iniciativën Ecovolis, pedatuan për të rritur ndërgjegjësimin e publikut në lidhje me mundësinë e lëvizjes pa makina.



Raiffeisen Bank mbështet për të katërtin vit radhazi projektin Ecovolis, duke krijuar stacione të biçikletave në Tiranë me qëllim të promovimit të çiklizmit. Me mbështetjen e Raiffeisen Bank gjatë vitit 2014, numri i stacioneve Ecovolis arriti nga 7 në 10 me një total prej 200 biçikleta. Ndërkohë, 2 kopshte u pajisën me stacione të vogla dhe biçikleta për 10 fëmijë.



Veneto Banka mbështeti iniciativën Ecovolis, veçanërisht në fushatën "Lironi Korsitë", si dhe në ngritjen e ndërgjegjësimin dhe duke ftuar të rinjtë të përdorin biçikletat.



Crédit Agricole Albania dhe Ecovolis vazhduan bashkëpunimin e tyre për të promovuar mjedis të pastër nëpërmjet ndërgjegjësimin të qytetarëve për t'iu drejtuar biçikletave, si një nga format e lëvizjes pa ndotje dhe njëkohësisht e shëndetshme. Ky bashkëpunim realizohet nëpërmjet stacionit të përbashkët të biçikletave pranë Sheshit "Skënderbej" dhe motos "Digj kalori, jo karburant".



Një Bankë Ekologjike



ProCredit Bank filloi në vitin 2014 një fushatë të brendshme Ekologjike - "Fillon nga unë", për të rritur ndërgjegjësimin dhe njohuritë në bankë mbi çështjet e mjedisit, për të motivuar përfshirjen e drejtpërdrejtë të stafit, dhe për të reduktuar përdorimin e energjisë dhe burimeve të tjera. Si rezultat i këtyre masave të brendshme, gjatë vitit 2014, banka uli në terma absolutë konsumin e energjisë elektrike me 18%, konsumin e letrës me 34%, konsumin e ujit me 46%, dhe konsumin e karburantit për transport me 18%, krahasuar me vitin e kaluar

Gjatë vitit 2014, **ProCredit Bank** organizoi takime të hapura me agrobizneset në rajonet e Korçës, Durrësit, Shkodrës, Fierit, me prodhues bulmeti, fermerë, dhe furnizues bujqësor, për të theksuar rëndësinë e masave të efikasitetit të energjisë në sektorin e agrobiznesit, për të rritur produktivitetin, përmirësuar proceset, rritur cilësinë e prodhimit, duke ulur kostot, me një ndikim pozitiv në mjedis.



Një prej iniciativave të gjelbra mbështetur nga banka ishte "Panairi i Ideve të Gjelbra", organizuar nga Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) dhe GIZ - Programi EDEP. Qëllimi i këtij projekti ishte promovimi i iniciativave studentore dhe ideve të biznesit, drejt një ekonomie të gjelbër nëpërmjet përdorimit efikas të energjisë dhe burimeve të tjera natyrore. ProCredit Bank ofroi një stazh 4-javor në Njësinë e Mjedisit për studentët me tre projektet më të mira.

Gjithashtu, banka mbështeti programin e SHUKALB (Shoqata Ujësllës Kanalizime e Shqipërisë), të quajtur "Miq të Ujit". Programi synon të rrisë ndërgjegjësimin që në moshë të vogël, tek fëmijët e shkollave fillore mbi çështjet e ujit, duke i njohur ata me konceptet bazë mbi burimet e ujit, dhe më tej duke i inkurajuar të shprehin çka mësojnë nëpërmjet vizatimeve. 12 më të mirat prej vizatimeve të mbledhura u përdorën për të krijuar një kalendar të bukur për vitin 2015.



Duke pasur parasysh rëndësinë e burimeve të rinovueshme të energjisë, në vitin 2014, banka mbështeti projektin e Bashkisë së Tiranës për të zëvendësuar 12 kaldaja naftë me ngrohës eficientë të ujit në 12 shkolla publike / kopshte të Tiranës. Zhvendosja drejt biokarburantëve zvogëlon sasinë e dioksidit të karbonit në atmosferë dhe përmirëson kushtet e jetesës së fëmijëve në shkolla / publike dhe kopshte duke siguruar ngrohje efikase.

Banka mbështeti edhe iniciativën e Qendrës së Edukimit Mjedisor (EDEN) për ndërtimin e "Shtëpisë Eko prej druri", në kopshtin zoologjik të Tiranës. Kjo shtëpi do të shërbejë si një qendër e edukimit mjedisor për tu dhënë vizitorëve të saj informacion mbi mjedisin, dhe si një shembull konkret i energjisë së rinovueshme dhe opsioneve ekologjike në Tiranë, të tilla si panelet diellore, llamba LED, etj..

Festa tradicionale kombëtare dhe lokale




Intesa Sanpaolo Bank Albania financoi me para dhe në natyrë (Bluza & sende promocionale) "Festën e Birrës" në Korçë, një traditë e Bashkisë së Korçës organizuar për vitin e 8 radhazi. Qyteti i Korçës është i njohur për prodhimin birrës së parë shqiptare dhe për fabrikën e një prej birrave më të njohura shqiptare në treg "Birra Korça", nga turistët vendas dhe ndërkombëtarë.

Intesa Sanpaolo Bank Albania mbështeti financiarisht edhe organizimin e "BunkArt Muze Expo", që hapi dyert në nëntor 2014 në kujtim të 70-vjetorit të Çlirimit. BunkArt transformoi bunkerin e fshehtë anti-bërthamor të epokës komuniste në një galeri të hapur ku publiku të njohë historinë e vërtetë të së kaluarës së tij.



Union Bank sponsorizoi aktivitetet e organizuara në qytetin e Elbasanit më 14 mars me rastin e festës "Dita e Verës".



Alpha Bank Albania organizoi aktivitete festive në qytetin e Pogradecit për të festuar ditët e Çlirimit dhe Pavarësisë së Shqipërisë më 28 dhe 29 nëntor.

BKT sponsorizoi organizimin e aktiviteteve nga Fondacioni Kulturor SKAMPA me rastin e festës "Dita e Verës" në Elbasan, një festë lokale që organizohet në këtë qytet dhe ndiqet nga mijëra njerëz nga e gjithë Shqipëria.



Tirana Bank mbështeti "Festën e Verërave", që është ngjarja më e rëndësishme për qytetin e Pogradecit. Për 2 ditë në dhjetor prodhuesit vendor të verës prezantuan produktet e tyre për një audience të gjerë në një event të kombinuar me shfaqje artistike.



Ndajmë kulturën dhe traditat

BKT kontribuoi në organizimin e festimeve me rastin e Ditës Kombëtare Turke të Fëmijëve, zhvilluar në ambasadën turke në Tiranë.



VËSHTRIME TË NDËRTHURURA:
"FRANCA NË SHQIPËRI"
REGARDS CROISÉS:
"LA FRANCE EN ALBANIE"
1912-1922

MUZEU HISTORIK KOMBËTAR - MUSÉE NATIONAL D'HISTOIRE
21.06.2012 - 01.07.2012

Credit Agricole Albania mbështeti printimin e foto albumit "Shqipëria në llogore luftrash", i cili u promovua në sallën e UNESCO-s pranë Muzeut Kombëtar. Albumi është një koleksion fotosh të realizuara nga autori Valter Gjoni, i cili paraqet kronologjinë e një dhjetëvjeçari (1912-1922) të historisë së Shqipërisë, porë me syrin e korrespondentëve të shtypit francez, të pranishëm në territorin shqiptar gjatë atyre viteve.



Credit Agricole Albania vazhdoi për të dytin vit radhazi bashkëpunimin e suksesshëm me Aleancën Franceze në Tiranë, në lidhje me French Cine-Club. Aktiviteti kishte për qëllim që të sjelli publikun shqiptar më afër me artin Francez. Publiku i interesuar kishte mundësinë të ndiqte filma falas të zgjedhur nga arkiva e pasur kinematografike Franceze, e cila u transmetua ne ekranin e Kinema Agimit.

Societe Generale Albania mbështeti Pranverën Frankofone në Tiranë, duke sponsorizuar një ekspozitë arti në Galerinë e Arteve në Tiranë, e hapur për publikun nga 26 mars - 19 prill 2014. Në ekspozitë u prezantuan rreth 60 punime publicitare (pankarta, reklama të botuara në mediat franceze, etiketa pijesh dhe djathi francez, etj.) që prezantuan historinë e Francës përmes një galerie humoristike heronjsh francezë.

Në kuadër të Pranverës Frankofone, **Credit Agricole Albania** dhe shkolla 9-vjeçare "Urani Rumbo" organizuan "Festën Franceze" në Gjirokastrë, një aktivitet ky i hapur për dashamirësit e kulturës frankofone. Në formën e një shfaqje variete, studentët performuan me recitime dhe këngë, të realizuara në gjuhën frenge. Shfaqja u ndoq nga një publik i gjerë dhe përfundoi me ndarjen e disa dhuratave simbolike.



Intesa Sanpaolo Bank Albania sponsorizoi edicionin e dytë të eventit gala “Gala Italia 2014, sfilata di Moda & Musica” organizuar në Vlorë nga Konsullata Italiane e Vlorës në korrik, për të promovuar kulturën italiane përmes modës dhe muzikës.



Intesa Sanpaolo Bank Albania mbështeti Dhomën Amerikane të Tregtisë në organizimin e piknikut vjetor për të festuar Ditën e Pavarësisë së Amerikës (4 Korrik) në bashkëpunim me Ambasadën e SHBA dhe komunitetin amerikan që punon e jeton në Shqipëri. Mbi 800 të ftuar morën pjesë në piknik - një event familjar me muzikë, lojra, ushqim, pije e fishekzjarrë, që solli atmosferën amerikane në Tiranë.



Veneto Banka sponsorizoi shfaqjen teatrale “Promessi Sposi”, vënë në skenë nga fëmijët e Shkodrës, organizuar nga Ambasada Italiane në Shqipëri, në kuadër të festimeve të Ditës Kombëtare të Republikës Italiane, në 2 qershor.



Intesa SanPaolo Bank Albania mbështeti aktivitetin e Ambasadës Italiane organizuar me rastin e “Ditës së Republikës Italiane” në rezidencën e Ambasadorit Italian, duke festuar në këtë mënyrë origjinën e historisë dhe kulturës së Italisë. Si një urë lidhëse, Banka synon në forcimin e marrëdhënieve dhe kontributit jo vetëm në fushën ekonomike por gjithashtu dhe në shkëmbimet e vlerave të përbashkëta kulturore midis dy vendeve.



Intesa Sanpaolo Bank Albania ka mbështetur disa Dhoma Tregtare (Italiane, Franceze dhe Amerikane) në iniciativën e tyre për të organizuar aktivitete në interes të përbashkët për agrokulturën dhe çështje të tjera.



Shfaqje, koncerte dhe festivale

Credit Agricole Albania mbështeti organizimin për herë të parë në vendin tonë të veprimtarisë “Music Festival!”. Nën moton “Bëni muzikë!”, kjo veprimtari kishte për qëllim të inkurajojë muzikantë amatorë të luajnë vullnetarisht në rrugë dhe hapësira publike. Në Shqipëri, festivali u realizua si bashkëpunim midis Aleancës Franceze në Shqipëri, Ambasadës Franceze dhe Bashkive të Tiranës, Korçës dhe Elbasanit. Përgjatë rrugëve të Tiranës, u organizuan parada muzikore nga një kompanie franceze, e cila paraqiti një tablo të muzikës dhe shfaqje cirku që përfundoi me një koncert në sheshin Skënderbej. Skena të improvizuara janë instaluar në sheshin Skënderbej.



Crédit Agricole Albania bashkëpunoi me Teatrin Kombëtar të Operas dhe Baletit për një nga për të mbështetur disa nga projektet e saj: 2 shfaqjet e baletit të sezonit artistik të pranverës të titulluara “Le Royaume Uni” dhe “La Stravaganza, me protagonist koreografin e mirënjohur francez me origjinë shqiptare, Angjelin Preljocaj. Banka mbështeti vënien në skenë të operës “La Boheme”, e cila u konsiderua një nga pjesët më tërheqëse të kalendarit artistik të nëntorit të TKOB. Opera e kompozuar nga Giacomo Puccini erdhi në skenën e TKOB nën drejtimin e dirigjentit Andrea Demanincor and Daniela Candiotta.



Crédit Agricole Albania në bashkëpunim me Teatrin Kombëtar Shqiptar solli në skenën e teatrit shfaqjen premierë “Liri në Bremen”, nga autori Rainer Werner Fassbinder. Drama ishte një nga shfaqjet më të rëndësishme të kalendarit të sezonit, e cila mori shumë duartrokitje nga publiku.

Veneto Banka sponsorizoi projektin “Transformers” të Piktorit të mirënjohur Gjergji Meta, që u konkretizua me një ekspozitë në Muzeun Historik Kombëtar.



Intesa Sanpaolo Bank Albania sponsorizoi edhe prezantimin e albumit të filmit klasik për fëmijë "Tomka dhe shokët e tij", në festivale të ndryshme ndërkombëtare të filmit, në mbështetje të ruajtjes së trashëgimisë kinematografike shqiptare me prestigj ndërkombëtar.



Alpha Bank Albania sponsorizoi një Koncert për Piano sjellë në skenë nga Orkestra Simfonike e Radiotelevizionit Shqiptar dhe pianistes soliste Silvana Skënderi nën drejtimin e dirigjentit grek Jorgos Chlitsios.



Intesa Sanpaolo Bank Albania mbështeti Festivalin Kombëtar të Komedisë dhe Teatrit në Korçë, organizuar për herë të parë në nivel kombëtar, duke sponsorizuar një nga çmimet. 12 grupe teatrale kombëtare me 15 aktorë morën pjesë në Festival.



BKT dhe Intesa Sanpaolo Bank Albania sponsorizuan "Ballon Presidenciale të fundvitit" të organizuar nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, të ardhurat e të cilës iu dhuruan Spitalit Pediatrik. Në praninë e personaliteteve të fushave të ndryshme, u dha një koncert i shoqëruar dhe me balet, për të promovuar artin dhe kulturën e artistëve shqiptarë.



Credins Bank sponsorizoi vënien në skenën të shfaqjes teatrale "Balloja e Diplomës" në Teatrin Kombëtar të Operës dhe Baletit.

Credins Bank sponsorizoi TRA.KU fest, një festival aktiviteteve të ndryshme, si konferenca akademike, festime tradicionale, vizita të organizuara, dhe koncerte të grupeve më të njohura në rajon, që zgjati gjatë 3 ditëve prej 31 korrik deri në 2 gusht, në Gjirokastrë.



Union Bank, mbështeti për të tretin vit radhazi, organizimin e Festivalit të Fëmijëve "Fest 2014", zhvilluar në Kukës, në 29 maj 2014.



BKT sponsorizoi Qendrën Kulturore të Fëmijëve në Fushë Krujë për organizimin e Festivalit të Muzikës Popullore për fëmijë.



Banka dhuroi edhe fonde për Cirkun Kombëtar Shqiptar për shfaqje me cilësi e standarde më të mira. Banka mbështeti gjithashtu festivalin ndërkulturor të mbajtur në Berat i cili përfshiu 12 aktivitete artistike me qëllim promovimin e traditës dhe kulturës së qytetit.



Raiffeisen Bank mbështeti për të dytin vit radhazi iniciativën e një grupi vullnetarësh (gra, vajza, fëmijë dhe designers) të cilët organizuan shfaqjen e modës "ekologjike" të titulluar "Eko Fashion Show", si pjesë e Festivalit të Filmit Mjedisor mbështetur gjithashtu dhe nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri. Mesazhi që transmeton kjo shfaqje është: Zvogëlo - riciklo - ripërdor - rikrijo.



Tirana Bank sponsorizoi koncertin klasik "Ndërmendje" të organizuar në qytetin e Shkodrës, në dhjetor. Ky koncert solli në skenë vepra të mrekullueshme klasike të kompozitorëve të huaj dhe vendas.



Tirana Bank sponsorizoi vënien në skenë për publikun shqiptar të kryeveprës operistike "Orfeo e Euridice".



Societe Generale Albania mbështeti edicionin e 14-të të Festivalit operistik "Marie Kraja", organizuar nga 31 tetor deri në 1 Nëntor, një ngjarje vjetore që bashkon këngëtarë ndërkombëtare të operës lirike, që sjellin në Shqipëri shkolla dhe përvoja të ndryshme profesionale.



Societe Generale Albania sponsorizoi edicionin e 10-të "Çmimet Kult", një ngjarje me rezonancë të madhe në publik dhe fushat e artit dhe kulturës, dhe me një ndikim të rëndësishëm në botën artistike. Akademia "Kult" organizoi ceremoninë e çmimeve vjetore të kulturës në të paktën 12 fusha të artit dhe kulturës.



Societe Generale Albania mbështeti edicionin e 3-të të Festivalit "Trena të Ndryshëm", që u mbajt nga 24 shtator deri në 1 tetor në Tiranë. Ky festival mbledh në një ngjarje të veçantë muzikore artistë shqiptarë me famë botërore dhe artistë e muzikantë të huaj që interpretojnë në skena nga e gjithë bota.



Sport

Raiffeisen Bank sponsorizoi sfidën e radhës së alpinistëve shqiptarë, pjesëtarë të Shoqatës Beshkatarë dhe Alpinistë, Tiranë, që ngjitën majën më të lartë të Amerikës së Jugut, Aconcagua 6962 m. Ekipi me të pestë alpinistët arriti të ngjitet dhe shpalosë flamurin e Shqipërisë në këtë majë të re, duke i shtuar sukseseve të tyre edhe një prej 7 majave më të larta të botës si Everesti dhe Denali.




Veneto Banka ishte për vitin e dytë radhazi sponsor i ekipit të Mini-Futbollit, Flamurtari i Vlorës, ndërkohë që ka qenë vazhdimisht mbështetëse e ekipeve si "Himara" Futboll dhe Volejball, "Besa" e Kavajës Futboll, etj.. Veneto Banka sponsorizoi edhe takimin përmbyllës të Superkupës së Shqipërisë në futboll.

Veneto Banka sponsorizoi Kampionatin Kombëtar të Beach Volley, të organizuar në 2014 nga Federata Kombëtare e Volejbollit në bashkëpunim me Bashkitë Himarë dhe Sarandë.

Veneto Banka është sponsor zyrtar i Rally Albania, dhe këtë vit, bashkë me skuadrën nga Veneto "Energia e Sorrisi", dhuroi ndihma për njerëzit në nevojë në Durrës dhe Elbasan.



Credins Bank sponsorizoi pjesëmarrjen e ekipit kombëtar shqiptar të peshëngritjes në Kampionatin Botëror të Peshëngritjes në Kazakistan, për vitin 2014.



BKT sponsorizoi pajisjet për sporte në natyrë që u vendosën në parkun publik të Komunës Kashar. Kjo është zona e parë sportive e cila mund të frekuentohet lirisht nga banorët e komunës.

BKT sponsorizoi aktivitetet e Drejtorisë Arsimore Rajonale të Tiranës, në organizimin e ndeshjeve sportive mes ekipeve të shkollave të ndryshme të Tiranës.



Çmime Speciale

Raiffeisen Bank u nderua me çmimin “Bleta e Artë”. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, nën kujdesin e Kryeministrit Edi Rama, organizoi në Teatrin e Operës dhe Baletit, eventin Gala “Bleta e Artë 2014”, ku u vlerësuan 15 bizneset më të mira të këtij viti. Qëllimi kryesor i aktivitetit ishte promovimi i aktivitetit të sipërmarrjes shqiptare dhe kontributit të saj në zhvillimin ekonomik dhe punësimin në vend.




Credins Bank u nderua me çmimin “Bizneset me kontribut në nivel kombëtar”, dhënë nga Shoqata Albanian Partners, e cila organizoi në 5 dhjetor 2014 ceremoninë Gala për dhënien e çmimeve fituesve të konkursit vjetor “Çmimi Filantropik”. Kjo ngjarje mbarëkombëtare organizohet për të vlerësuar dhe shprehur mirënjohje dhe falënderime për individët dhe bizneset që kontribuojnë për përmirësimin e cilësisë së jetës së shoqërisë.

Credins Bank u vlerësua si kompania më e mirë për mbështetjen e vazhdueshme në fushën e shëndetësisë, arsimit, artit dhe kulturës, dhe në mënyrë të veçantë për ndihmën e konsiderueshme dhënë për rindërtimin e spitaleve, ndërtimin e laboratorëve kimike dhe pajisjen e laboratorëve me pajisje mjekësore në spitalet rajonale të Durrësit, Shkodrës, Vlorës dhe Spitalit Ushtarak Qendror Universitar.



ProCredit Bank fitoi çmimin e Përgjegjësisë Sociale të Korporatës “Praktikat për kompanitë e mëdha”. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes në bashkëpunim me UNDP-në dhe Rrjetin Shqiptar për Përgjegjësinë Sociale të Korporatës, organizuan forumin shumëpalësh për Përgjegjësinë Sociale të Korporatës. Forumi shërben si një platformë konsultative për promovimin e CSR në Shqipëri, me përfshirjen e shumë pjesëmarrësve. Gjatë këtij forumi, Ambasadori i Gjermanisë në Shqipëri, Z. Hellmut Hoffmann, i dha ProCredit Bank Çmimin për CSR.





*Ky raport i parë për CSR u ideua dhe zhvillua
Sekretariati i AAB-së dhe u përgatit nga
zj. Junida Tafaj,
Oficere Operacionesh në AAB.
Ky botim paraqet materialin e mbledhur nga
bankat anëtare të AAB-së mbi iniciativat dhe
aktivitetet e tyre kryesore në CSR gjatë vitit 2014.*



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

"Ibrahim Rugova" Str.
SKY TOWER, 9th Floor, AP. 3, Tirana
Phone: +355 4 2280 371; Fax: +355 4 2280 359
E-mail: secretariat@aab-al.org; www.aab.al